

Jaho MARGJEKA

MOTIVI I VETEFLIJIMIT SI DHIMBJE DASHURIE NE POEZINE E BESIM XHELILIT
Besim Xhelili - "Dallgë në zemër", 183 lirika të dhimbshme dashurie.

"Dallgë në zemër"- 183 lirika të dhimbshme dashurie, titullohet njëri nga gjashtë librat e poetit Besim Xhelili, të cilin po promovojmë sot, që në të vërtetë janë 183 strofa që përbëjnë një "poemë" të bukur e të dhimbshme dashurie.

Që kur lindi njerëzimi e njeriu mori penën për të shkruar, krahas bëmave e trimërive në fushën e betejës, ai njeriu-poet, ia besoi letrës së bardhë, ndjenjat më të holla e delikate të zemrës së tij. Kështu kanë rrugëtuar deri tek ne lirikat e ndjera të Safos, vargjet e hyjnishme të Dantes për Batricen e tij, apo "Spiculum" e Pjeter Budit, kënga e parë lirike e një poeti të mirëfilltë shqiptar, për t'u ndjekur me një këngë tjetër lirike, një shekull më pas, siç është cikli i "Sibileve" të Pjetër Bogdanit e për t'u shfaqur në shekullin e tetëmbëdhjetë, në përmasa më të gjera, me një zë të plotë lirik, poeti Jul Variboba me poemën "Gjella e Shën Mërisë së Virgjër". Pa harruar Zef Seremben e pafat e Çajupin tragjik, Naimin altruist e Poradecin sqimatar, e për të ardhur tek të gjallët e sotëm, njëri prej të cilëve është poeti Besim Xhelili.

Muza e Xhelilit herë është Evë e herë Beatrice, herë Helenë Troje e herë Zanë mali e Lugjeve të Verdha, herë e ëmbël e herë pelin, herë gjarpërushë e herë lozonjare. Ajo (Muza) është gëzimi e njëkohësisht dhimbja e zemrës së poetit, te cilën ai (poeti) ia ka blatur plotësisht asaj, pa asnjë "kusht", ashtu siç është e pakushtëzuar dashuria:

*"E shoh se sonte prapë më qahet,
Zemër e kalbur në gjoks a mbahet?"*
Strofa 7, fq. 11.

Dhe po në të njëjtën strofë poeti na jep edhe një informacion për përmasën dhe intensitetin e ndjenjës:

*"Fyti më është ngushtuar dhe tharë,
Që dhjetë ditë vdiqa pa të parë".*

Semantika e rrëfimit poetik vijon me monologun e brendshëm, që shpesh merr trajtën edhe të dialogut me objektin poetik. Si në tragjeditë e vjetra, si ajo e Romeos e Zhuljetës, heroit lirik është i gatshëm të flijohet për dashurinë apo zgjedhjen që bëjnë heronjtë lirikë të Safos "Hadin", mbretërinë e nëndheshme.

*“Ke të drejtë s’mundem të ta fali botën,
Vetëm këtë jetë në duar ta dhuroj
Ma bëj gati varrin dhe hape gropën
Aty i lumtur unë përjetë do të pushoj”.*

Strofa 43, fq. 25.

Motivi i flijimit për dashurinë është gjerësisht i kudogjendshëm në lirikën popullore, por shpesh është edhe një realitet i kohës. Njëri prej heronjve lirikë nuk i reziston pabarazisë së ndjenjave, apo refuzimin e tyre, e zgjidhja gjendet tek udha e pa kthim. Megjithatë në moment kthjellimi njëri prej heronjve tanë lirikë ia kujton tjetrit këtë “pabarazi”, duke shkarkuar sadopak nga vetja një pjesë të barrës emocionale:

*“Shoh si ngre gotën e gëzuar e qeshur
Se te dua s’ndjehesh fare e mërzhitur,
As për fytyrën që vdekjen ka veshur
As për zemrën që digjet duke pritur”.*

Strofa 47, fq. 27.

Poeti në hapërimin e rrugëtimit të tij poetik kërkon më kot “ilaç” për zemrën duke ia pohuar për të satën herë vetes se shërim e shpëtim për zemrën e dashuruar janë vetëm sytë e mikes. Zaten kemi të bëjmë me një blatim të pastër, pa epsh e fëlligështi, megjithatë larg e të ndarë “*si në dy ishuj*” - Strofa 64, fq. 67.

Por dalëngadalë heroi lirik siç duket fillon të pajtohet me realitetin duke arritur në përfundimin se “Pjese e jetës është edhe vaji” -Strofa 71, fq. 40.

Ai tashmë është i vetëdijshëm për përmasat e sagës së tyre dhe interesohet edhe për miken. “*O dritë e shenjtë,... Më shumë dua ti mos vuash*”- Strofa 72, fq. 40. Duke ia pohuar prapë e prapë vetes se “*Dhimbja në gjoks është dashuri*”. - Strofa 74, fq. 41.

Poema 183 strofëshe, “Dallgë në zemër”, vijon më pas si një “Ditar dashurie”, ku heroi lirik rrëfen përditshmërinë e tij shpesh deri në imtësira duke përcjellë herë pas here kumte të singërta dashurie. Biles, “*Nëse një dite fati na sjell të takohemi, S’duhet t fshihemi, të ikim, të largohemi*”, shkruan poeti. Strofa 107, fq. 53.

Megjithatë dhimbjet e shpirtit shpesh bëhen të padurueshme e edhe pse *“Bota është e ëmbël”* heroit lirik edhe *“i vdiset”*. - Strofa 110, fq. 54. Biles duke zgjedhur edhe mjetet për t’ia arritur kësaj. *“Në dorë kam me helm të mbushur një gotë”* se, *“Pa qeshjen tënde hëna kurrë s’bëhet e plotë”*. - Strofa 113, fq. 55.

Lëngata e heroit lirik është e thellë dhe gati e pashpresë, askush s’mundet ta ndihmojë, biles as vet Krijuesi (Perëndia), ndaj së cilës indirekt edhe *“ankohet”*:

*“Perëndia i do dhe i shpërblen njerëzit e mirë
Vetëm mua sikur s’ma plotëson asnjë dëshirë”*, - Strofa 134, fq. 68.

Megjithatë shërimin apo *“fundin”* e zemrës së lënduar ai e kërkon tek një fuqi po aq e madhërishme dhe hyjnore, tek magjia e Artit. *“Le t’më vdes zemra mes poezive”*. - Strofa 137, fq. 69. Ja pra, çfarë fuqie ka poezia, zbut mërzinë e trishtimin dhe kthjellon mendjen e shëron zemrën, derdh gotën e helmit për ta mbushur atë plot e përplot me vere, mushtin e bekuar të frymëzimit që thërret muzat. Pavarësisht kësaj ai s’heq dore lehtë, s’pranon të dorëzohet, por prapë sikur thërret e *“lutet”*. *“Nga buzëqeshja jote unë do të shërohem”*, - Strofa 140, fq. 70. I drejtohet ai çiltërsisht vetes dhe Asaj që ia ka blatur zemrën dhe se çfarë do që të ndodh ai do ta ketë përherë aty, në zemër:

*“E nëse buzën ta lag ndonjëherë një lot
dije se unë do të të dua përjetë e mot”*. - Strofa 148, fq. 73.

Është interesante antiteza e përjetshme, dashuri-vdekje. Dashuria, filizi i jetës e vdekja mbarimi i saj. Kur je i dashuruar është koha edhe të vdiset. Vdekja për dashurinë në konceptin e protagonistit lirik është një trimëri e shpirtit, është një heroikë prej martiri. *“Oh Perëndi, zemra kur degdiset, Mendoj se është koha të vdiset”*. - Strofa 156, fq. 76. Megjithatë siç thotë Friedrich NIETZSCHE, *“Gjithmonë ka ca çmenduri në dashuri. Por po ashtu gjithmonë ka ndonjë arsye në çmenduri”*.

*“Buzët e tua më përvëljuan sa i preka
Atë natë të fshehtë e të përplotshme,
Në thellësinë e tyre jetën unë gjeta
Ika nga tmerri i kësaj jete të lodhshme”*. - Strofa 167, fq. 80.

Ideja e vetëflijimit vete here pas here në horizontin plot re e detin plot tallaze të dashurisë. Por një vetëflijim paksa i kushtëzuar, jo fundor e aq tragjik. Një flijim paksa më i arsyeshëm:

*“Shpirti ka nisë të më dobësohet
Zoti në mëngjes mos më zgjoftë
Nëse dashuria për ty më ftohet
Zemra copë-copë m’u copëtoftë”*. - Strofa 174, fq. 83.

E *“Nëse do të ëndërrosh, duhet te zgjohesh”*, këshillon Paulo Coelho.

*“Po fjalë as arsye nuk më dhe pse më largon,
Tani zemra për dikë tjetër të punon”...
“S’ke nevojë më për fjalë të kota
Mua le t’ më hanë qentë e të tallet bota”*. - Strofa 182, fq. 86.

Edhe Heroi ynë tashmë është zgjuar e kthjellur. Cirqet e përjetshme, Evat e Beatricet, Helenat e Trojës e Shtojzovallet e Lugjeve të Verdha buzëqeshin ëmbël duke ëndërruar edhe ato një zgjim te ri. Dhe paqja ka ardhur. E *“Në paqe edhe armikut i zgjatet dora”*,... - Strofa 183, fq. 86,...Strofa e fundit e sagës të Dallgëve të zemrës së Besim Xhelilit.

Urime të singerta poetit Besim Xhelili.
Faleminderit.

Jaho MARGJEKA
Tiranë, 20 nëntor 2016